

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
NR. KOL 1287  
NR. REP 1364

KONTRATE PENGU

MBI KUOTAT E PJESEMARRJES NE SHOQERI

Sol, me 11/7 /2014 (dymije e katermbedhjte), ne Korce, perpara meje Blaze Anani Noter i Dhomes se Noterise Korce, me seli ne Korce u paraqiten perfaqesuesit e paleve te meposhtme:

PENGMARRRES / KREDIDHËNES:

**Raiffeisen Bank Sh.A.**, një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NIPT nr.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Znj.Aiketa EMINI dhe Znj.Donika GJINI (ketu e me poshte do te quhet "Banka" ose "Pengmarresi").

Dhe

KREDIMARRRES:

Shoqeria "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr. 25412, datë 13.03.2001 me seli ne Rruga Nacionale Korce-Bilisht, KM 2 e perfaqesuar ne baze te Vendimit te Asamblese se Ortakeve nr. \_\_\_\_\_ date \_\_\_\_\_ nga ortaku **Z.Aristotel Mindili** (ketuj e tutje Kredimarrres);

Shoqeria "COLOR BODY" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, me NIPT K84123002A me seli ne Rruga Nacionale Korce-Bilisht, KM 4 e perfaqesuar ne baze te Vendimit te Asamblese se Ortakeve nr. \_\_\_\_\_ date \_\_\_\_\_ nga ortaku **Z.Aristotel Mindili** (ketuj e tutje Bashkekredimarrres);

Dhe

PENGDHENESI:

**Aristotel Mindili**, i biri i Dhimitraqit, dtl. 28.03.1971, lindur ne Korce dhe banues ne adresen Lgj. Nr. 2, Rr. 'Kristo Grabocka' Nr. 13, Korce identifikuar me leternjoftim nr. 027637865. (ketu e me poshte do te quhet "Barredhenes").

**Polizoi Mindili**, i biri i Dhimitraqit, dtl. 27.11.1967, lindur ne Korce dhe banues ne adresen Lgj. Nr. 2, Rr. 'Kristo Grabocka' Nr. 13, Korce identifikuar me leternjoftim nr. 030737535. (ketu e me poshte do te quhet "Barredhenes").

**Savvas Chaliampalias**, i biri i Viktorit, dtl.11/04/1963, lindur Selanik, Greqi, banues ne adresen Selanik, Greqi, identifikuar me ID nr. AH3309735, (ketu e me poshte do te quhet "Pranues kontrate").

Baza Ligjore

Kjo kontrate hartohet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 423, 532-540 K.Civile. Nenet 546 e ne vijim. 605, 1031 e ne vijim te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

KUSHTET PARAPRAKE:

(A) Sipas kushteve te Kontrate Per Financimin dhe Perdorimin e Limitit te Pergjithshem te Kartes se Kreditit te Shoqerise nr. \_\_\_\_\_ rep, nr. \_\_\_\_\_ kol date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2014 dhe Kontrate Per Leshimin e Instrumentave Financiare dhe/ose Kredie me Kufi nr. \_\_\_\_\_ rep, nr. \_\_\_\_\_ kol date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2014 (me poshte referuar si Kontrate Kredie) lidhur midis Shoqerive "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk, "COLOR BODY" shpk dhe Bankes Raiffeisen do t'i japin kesaj shoqerie kredi, siç percaktohet ne Kontrate e Kredise.

(B) Si kusht paraprak per dhenien e linjes se kredise nga Kredithenesi Raiffeisen Bank tek HROMODHOMIA ALBANIA" shpk dhe "COLOR BODY" shpk, palest kane rene dakort te lidhin kete Kontrate Pengu mbi kuotat e pjesemarrjes ne shoqerite "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk dhe "COLOR BODY" shpk, keshtu;

Z. Aristotel Mindili është pronar i regjistruar i 50% (pesedhjte perqind) të kapitalit të Shoqërisë "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk, dhe një numri prej 50 (pesedhjte) aksionesh/kuotash me vlere nominale 176,780.09 ALL (njqind e shtatedhjte e gjashte mije e shtateqind e tetedhjte pike nente lek) per aksion/kuote.

Z. Savvas Chaliampalias është pronar i regjistruar i 50% (pesedhjte perqind) të kapitalit të Shoqërisë "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk, dhe një numri prej 50 (pesedhjte) aksionesh/kutash me vlere nominale 176,780.09 ALL (njqind e shtatedhjte e gjashte mije e shtateqind e tetedhjte pike nente lek) per aksion/kuote.

Z. Aristotel Mindili është pronar i regjistruar i 50% (pesedhjte perqind) të kapitalit të Shoqërisë "COLOR BODY" shpk, dhe një numri prej 50 (pesedhjte) aksionesh/kutash me vlere nominale 1,000 ALL (nje mije lek) per aksion/kuote.

Z. Polizoi Mindili është pronar i regjistruar i 50% (pesedhjte perqind) të kapitalit të Shoqërisë "COLOR BODY" shpk, dhe një numri prej 50 (pesedhjte) aksionesh/kutash me vlere nominale 1,000 ALL (nje mije lek) per aksion/kuote.

(të gjithë aksionet/kuotat sipas pikave (B) do të quhen këtu më poshtë se bashku "Aksionet/kuotat").

(C) Si kusht paraprak per dhenien e kredise, Pengdhenesit kane rene dakort, t'i vene ne dispozicion Kredithenesit/Pengmarresit (siç perkufizohen me poshte) Kontrate Peng mbi aksionet/kuotat e pjesemarrjes ne shoqeri qe Pengdhenesit zoterojne dhe do te zoterojne ne te ardhmen ne kapitalin e Shoqerise, ne menyre qe te siguroje permbushjen e detyrimeve te shoqerive "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk dhe "COLOR BODY" shpk, kane sipas Kontrate Per Financimin dhe Perdorimin e Limitit te Pergjithshem te Kartes se Kreditit te Shoqerise nr. \_\_\_\_\_ rep, nr. \_\_\_\_\_ kol date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2014 dhe Kontrate Per Leshimin e Instrumentave Financiare dhe/ose Kredie me Kufi nr. \_\_\_\_\_ rep, nr. \_\_\_\_\_ kol date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2014.

ESHTE RENE DAKORT si me poshte vijon:

## 1. DISPOZITA PARAPRAKE

### 1.1 Kushtet paraprake dhe shtojcat

Kushtet paraprake dhe shtojcat e kesaj Kontrate perbejne pjese themelore te saj, dhe jane te detyrueshme si per Palet, ashtu edhe per trashegimtarët, si dhe te tretteve te cileve mund t'u kalojne te drejtat dhe/ose detyrimet e kesaj Kontrate.

### 1.2 Perkuftizime

Pervecse kur eshte parashikuar ndryshe ne kete Kontrate (qofte specifikisht ose me reference), termat e percaktuara ne kontratat e kredive do te kene te njejtin kuptim ne kete Kontrate

"Kontrate Pengu" do te thote kjo Kontrate, siç mund te ndryshohet dhe/ose riformulohet here pas here.

"Ligji i Zbatueshem" do te thote Kushtetuta e Republikes se Shqiperise dhe ligje ose akte te tjera nenligjore te Republikes se Shqiperise, ne fuqi dhe te zbatueshme ne çdo kohe dhe here pas here per sa kohe qe kjo Kontratedo te zbalohet.

"Kodi Civil" do te thote Ligji Shqiptar nr.7850, date 29 Korrik 1994, me ndryshimet perkatese.

"Kodi i Procedures Civile;" do te thote Ligji Shqiptar nr. 8116, date 29 Mars 1996, me ndryshimet perkatese.

"Peng" do te thote Aksionet/Kuotat te tashme dhe te ardhshme dhe te Drejtat e Lidhura me to, te vendosura ne favor te Kredidhenesit sipas nenit 2 te kesaj Kontrate dhe sipas kontratat e kredive.

"Rasti i Ekzekutimit te Detyrueshem" do te thote ndodhia dhe/ose vertetimi i njeres prej Rasteve te Mospembushjes siç specifikohen ne kontratat e kredive.

"Te Drejtat e Lidhura " do te thote:

- (i) çdo dividend ose interes i paguar ose i pagueshem ne lidhje me aksionet/kuotat;
- (ii) çdo aksion/kuote, letra me vlere, te drejta, te holla ose pasuri te lindura ose te ofruara ne çdo kohe (qofte me ane te kthimit, bonus, preferimit, te drejtave me kusht, zevendesimin, kembimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilendo nga Aksionet/Kuotat;
- (iii) te gjithë dividende, interesat ose te ardhura te tjera ne lidhje me çdo aset te pemundur ne paragrafin (ii) me lart; dhe
- (iv) te gjithë te drejtat e votes ne lidhje me Aksionet/Kuotat, te cilat mund te ushtohen si ne asamblene e zakonshme, ashtu edhe ne asamblene e jashtezakonshme te Shoqerise, sipas Nenit 6 te kesaj Kontrate.

"Detyrimet" do te thote:

- (i) te gjithë detyrimet monetare (dhe detyrimet te cilat mund te vlersohen ne te holla) dhe detyrimet e Shoqerise kundrejt Kredidhenesit sipas kontratat e kredive; dhe,
- (ii) te gjithë detyrimet e Shoqerise dhe te Pengdhenesve kundrejt Kredidhenesit sipas kesaj Kontrate

"Pranues te Kontrates se Pengut " do te konsiderohen bashkeshortet e secilit nga Pengdhenesit individe te cilet ne kuptim te Kodit te Familjes konsiderohen bashkepronare te aksioneve te zoteruara nga bashkeshortet e tyre, dhe qe me nenskrimin dhe pranimin e kesaj kontrate japin miratimin e tyre per vendosjen e Pengut ne favor te Kredidhenesve Kryesore.

### 1.3 Interpretim

- (a) Ne kete Kontrate (si dhe ne te gjithë dokumentet e tjere ne lidhje me kete Kontrate), pervecse kur qellimi i perdorimit eshte dukshem i ndryshem, nje reference per:
  - (i) "akt normativ" perfshin çdo rregullore, rregull, urdher zyrtar, kerkese apo udhezim (qe mund te kete ose jo fuqine e ligjit) te çdo autoriteti qeveritar, agjensie, departamenti apo institucioni rregullator, vete-rregullues apo çdo lloj organizate apo autoriteti shqiptar;
  - (ii) "person" perfshine çdo individ shqiptar apo te huaj, çdo person juridik, firme, shoqeri, ortakeri, ent shteteror ose joint-venture, dhe perfshin trashegimtarët dhe personat te cileve u kane kaluar te drejtat dhe detyrimet e kesaj Kontrate;
  - (iii) çdo Nen, paragraf ose Shtojce, perben nje reference per kete Nen, paragraf apo shtojce te kesaj Kontrate, pervecse kur eshte percaktuar shprehimisht ndryshe;
  - (iv) kjo Kontrate, ose çdo dokument tjeter, kontrate, perfshin referimet te kjo Kontrate ose keto dokumente ose kontrata, siç mund te ndryshohen, perpunohen ose shtohen here pas here;
  - (v) "Palet"i referohet bashkerisht Shoqerise dhe Pengdhenesve.
- (b) Nesë kerkohet permbajtja, fjalet e perdorura ne numrin njejes perfshijne edhe numrin shumes dhe anasjelltas, dhe fjalet e perdorura ne nje gjini perfshijne te gjitha gjinite.
- (c) Titujt ne kete KontrateKontrate perdoren vetem me qellim orientimi.

## 2 OBJEKTI I KONTRATES

### 2.1 Krijimi i Pengut

Pengdhenesit, si nje garanci per shlyerjen e plate dhe te pakthyeshme te Detyrimeve te Garantuara, me ane te ketij akti (i) ne menyre te pakthyeshme japin peng Aksionet/Kuotat, ne favor te Kredidhenesit (ii) ne menyre te pakthyeshme bien dakort per dhenien dhe krijimin e nje pengu mbi Kuotat e pjesemarrjes ne shoqeri dhe te drejtat e lidhura me to ne favor te Kredidhenesit, Raiffeisen Bank dhe (iii) çdo aksion/kuote e re e Shoqerise ose te drejtat e lidhura me to qe mund te zoterohen ne te ardhmen nga Pengdhenesit.

### 3 DETYRIMET E GARANTUARA

Pengdhenesit Kredidhenesit jepet si garanci e radhes se pare per dhe deri ne permbushjen e plate dhe te pakushtezuar te Detyrimeve te Siguruara. Pengdhenesit Kredidhenesit nuk do te reduktohet ne asnje menyre per arsye te shlyerjes se pjesshme te Detyrimeve te Garantuara.

### 4 KOMPLETIMI

- (a) Shoqeria duhet te pajise Banken me vendimin e asamblese se ortakeve/aksionereve qe autorizon krijimin e Pengut. Ky vendim depozitohet ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe nje ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Shoqerise qe mbahet prane Regjistrin Tregtar dhe provon regjistrimin e Pengut, do ti dergohet Bankes.
- (b) Pengdhenesit dhe Shoqeria me ane te ketij akti autorizojne Kredidhenesin te nenshkruaje, kompletoje, regjistroje dhe depozitoje te gjitha dokumentet e metejshme qe Kredidhenesi konsideron te nevojshme ose te pershtatshme. Pengdhenesit dhe Shoqeria do te nenshkruajne, kompletojne, regjistrojne, dergojne dhe depozitojne te gjitha dokumentet e metejshme qe Kredidhenesi mund te kerkojne ne menyre te arsyeshme per te realizuar qellimet e kesaj Kontrate, per te kompletuar dhe siguruar vazhdimesine e Pengut, per mbrojtjen dhe ruajtjen e Kolateralit dhe ekzekutimin e te drejtave te Kredidhenesit sipas kete Kontrate.

### 5 EKZEKUTIMI I PENGUT

Ne perputhje me Nenin 556 te Kodit Civile; me e vertetimin e nje Rasti Ekzekutimi te Detyrueshem dhe ne çdo kohe pasketaj, dhe ne zbatim te dispozitave te kontratat e kredive, Bankaka, pa cenuar te drejtat e tjera ose rivendosjen ne vend te tyre sipas ligjit ne fuqi, te gjitha te drejtat dhe mjetet e rivendosjes se te drejtave te parashikuara ne Nenet 510 e vijim i Kodit te Procedures Civile.

### 6 TE DREJTAT E VOTES DHE DIVIDENDET

#### 6.1 Te drejtat e votes

Deri ne permbushje te plate te detyrimeve ose derisa vertetohet nje rast i ekzekutimit te detyrueshem, te drejtat e votes te lidhura me Aksionet/Kuotat, ne asamblene e zakonshme si dhe ne asamblene e jashtezakonshme te Aksionareve/Ortakeve te Shoqerise, do te ushtrohen nga Pengdhenesit, me kusht qe keto te drejta te mos ushtrohen ne asnje rast nga ta ne nje menyre te tille qe do te mund te cenonte vlefshmerine dhe zbatueshmerine e kesaj Kontrate dhe/ose e cila nuk eshte ne perputhje me dispozitat e kontratave te kredive apo çdo kontrate tjeter te lidhur me te.

#### 6.2 Dividendet

Pengmarresi/Banka, ne perputhje me Nenin 550 K.Civile, ka te drejte te perfitoje te gjitha dividendet qe rrjedhin nga Aksionet/Kuotat me qellim pagimin e detyrimeve qe mund te kete ka ndaj saj shoqeria. Ne rast se shoqeria nuk ka detyrime ne vonese, Pengdhenesit do te kene te drejte te perfitojne keto dividente.

#### 6.3 Vertetimi i nje Rasti Ekzekutimi te Detyrueshem

Me vertetimin e nje Rasti Ekzekutimi te Detyrueshem, Banka do t'i dergoje nje njoftim Pengdhenesve dhe Shoqerise duke informuar se eshte vertetuar nje Rasti i Ekzekutimi te Detyrueshem dhe gjate kohezgjatjes se Rastit te Ekzekutimit te Detyrueshem dhe deri sa Kredidhenesi te informojne Pengdhenesit dhe Shoqerine me shkrim se Rasti i Ekzekutimit te Detyrueshem ka pushuar se ekzistuar, Banka ka te drejte, por nuk eshte e detyruar qe te perfoje te gjitha dividendet qe lidhen me Aksionet/Kuotat. Dividentet e perfituar ne kete menyre nga Kredidhenesi do perdoren per shlyerjen e Detyrimeve te Siguruara te mospermbushura deri ne ate date. Kredidhenesi do te kete titull te vecante menjehere te ekzekutueshem per te perftuar ne menyre te drejtperdrejte nga Shoqeria te gjitha dividendet ose pagesat e tjera ne perputhje me Nenin 550 te kodit Civil.

### 7 DEKLARATA DHE GARANCI

#### 7.1 Deklarata dhe Garancite e Pengdhenesve

Pengdhenesit dhe Shoqeria deklarojne dhe garantojne Banken si vijon:

- (a) Pengdhenesit jane pronare ligjore te Aksioneve/Kuotave. Nuk ekziston asnje barre siguruese apo peng mbi Aksionet/Kuotat, ne favor te te treteve, pervec Pengut te krijuar nepermjet kesaj kontrate;
- (b) nuk jane paraqitur kerkesa padi apo pretendime ne proces ose Pengdhenesit nuk jane ne dijeni per ndonje kerkesa padi apo pretendim potencial te ngritur perpara ndonje gjykate apo paneli arbitrazhi ne Republikën e Shqiperise apo jashte saj, lidhur me Kolateralin;
- (c) Shoqeria nuk eshte ne gjendjen e paafesise paguese dhe as nuk parashikohet nje gjendje e tille.
- (d) Shoqeria nuk ka detyrime tatimore te papaguara dhe as nuk parashikohet nje gjendje e tille.
- (e) Nuk do te kryhet asnje zmadhim kapitali me emetim aksionesh te reja apo veprim tjeter qe mund te shkaktoje zvogelimin e pjesemarrjes te secilit Pengdhenes ne kapitalin e Shoqerise, pa miratimin paraprak me shkrim te Kredidhenesit. Gjithashtu nuk do te kete asnje ndryshim ne strukturen e aksionereve/ortakeve, apo ne strukturen administrative dhe drejtuese te shoqeri, pa miratim paraprak me shkrim te Kredidhenesit.

### 8 ANGAZHIMET

#### 8.1 Angazhimet e Pengdhenesve

Deri ne perfundimin e kesaj Kontrate ne perputhje me kete Nen 8 Pengdhenesit duhet qe me shpenzimet e tyre:

- (a) t'i japin menjehere dhe te detyrojne Shoqerine qe t'i jape menjehere Bankes te gjitha njoftimet dhe dokumentat e tjera te marra ne lidhje me Kolateralin, duke perfshire, pa kufizim kerkesat e bera nga palet e treta ;
- (b) te detyrojne Shoqerine, te mbaje procesverbale te mjaftueshme dhe ti mundesoje Bankes te drejten per te bere kopje dhe ekstrakte te procesverbaleve;
- (c) te nenshkruajne dhe dergojne menjehere te gjitha dokumentat si dhe te marrin gjithe veprimet e nevojshme apo te keshillueshme ne menyre qe:
- (d)
  - (i) te regjistrojne dhe te mbajne ne fuqi te plote Pengun per Kredidhenesin;
  - (ii) te sigurojne qe mbi te gjitha Aksionet/Kuotat e ardhshme dhe te drejtat e shoqerise te lidhura me to te nenshkruara nga Pengdhenesit te jete vendosur Peng ne favor te Kredidhenesit ne perputhje me Nenin 2.1.; dhe
- (e) te mos ndryshojne formen e Shoqerise, pervec kur Banka ka dhene pelqimin me shkrim, dhe qe ky pelqim te mos pengohet pa arsye;
- (f) te mos shese apo disponoje te gjitha apo pjese te pronesise apo te te drejtave te kolateralit;
- (g) te nenshkruajne, pranojne dhe te dorezojne dokumentat sic mund te kerkohet ne menyre te arsyeshme nga Banka, ne menyre qe ti sjellin efekte kesaj Kontrate dhe te paguaje per te gjitha shpenzimet e kerkimit, regjistrimit dhe depozitimit.
- (h) Te paraqesin ne Banke/te Pengamarresi cdo dokument financiar qe tregon gjendjen finaniare te shoqerise ( kjo dhe ne rast se ndodh Rast Mospermbushje apo gjate ekzekutimit ) me qellim qe Pengamarresi ne cdo moment te jete i informuar per ecurine e shoqerise .

## 8.2 Perfundimi dhe Çlirimi

Pas permbushjes se Detyrimeve, Shoqeria dhe/ose Pengdhenesit mund ti kerkojne, dhe Banka do te jete e detyruar te konfirmoje brenda 1 (nje) muaj pas marrjes te kesaj kerkeses, qe Detyrimet jane paguar dhe shlyer totalisht. Pervec kur Banka e njofton Shoqerine dhe/ose Pengdhenesit per ndonje pretendim pezull, kjo Kontratedo te zgjidhet dhe Pengu do te çlirohen nga Kredidhenesi me kete konfirmim.

## 9 NJOFTIMET

### 9.1 Adresat

Te gjitha njoftimet sipas kesaj Kontrate apo ne lidhje me te do te dergohen ne adresat e deklaruara sipas kesaj kontrate. Pengdhenesi deklaron dhe pranon qe te gjitha llojet e njoftimeve te bera ne kete adrese do te konsiderohen si te marra nga ai. Pengdhenesi eshte i detyruar qe te njoftoje menjehere cdo ndryshim ne adresen e tij. Per sa kohe qe ai nuk ka njoftuar adresen e re, ai nuk ka te drejte te kundërshoje njoftimet e bera ne adresen e meparshme

### 9.2 Ndryshimi i Adreses

Secila nga palet mund t'i komunikojte te tjereve me poste rekomande nje tjeter adrese per te gjitha njoftimet.

### 9.3 Forma e Njoftimit

Te gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera sipas kesaj KontrateKontrate apo ne lidhje me te jepen me shkrim dhe, nese nuk kerkohet ndryshe edhe nga legjislacioni i zbatueshem, mund te dergohet me faks. Cdo njoftim i tille do te konsiderohet se eshte dhene nese faksi eshte marre nga marresi , me kusht qe njoftimi i dhene ne nje dite jo-pune do te konsiderohet se eshte marre ditën pasuese te punes

## 10 DISPOZITA TE NDYSHME

### 10.1 Ndryshime dhe perjashtime

Asnje ndryshim apo perjashtim nga dispozitat e kesaj KontrateKontrate nuk do te kete fuqi ligjore pervec rastit kur ai behet me miratim me shkrim te Paleve. Kredidhenesi mund te miratojne zgjatje te afateve kohore dhe lehtesira te tjera, kompromise, pajtime, falje dhe çlirim nga detyrimi ose te merrret vesh me shoqerine lidhur me Kolateralin sic do te gjykohe dhe pershtatshme prej Kredidhenesit, pa rene ndesh me pergjegjesine e Shoqerise dhe te Pengdhenesve dhe te drejtat e detyrimit e Kredidhenesit sipas kesaj Kontrate apo sipas legjislacionit te zbatueshem ose ndonje ligji te zbatueshem

### 10.2 Ndryshime, Trasferime, Ripertesitje

Kjo Kontrate do te jete detyruese per Pengdhenesit dhe Shoqerine, Banken edhe trashgimtarete e tyre respektive, cesionaret apo te tretet te cileve u ka kaluar kontrata, edhe ne rast te ndryshimit, transferimit apo ripertesitjes se kontratave te kredive apo kesaj Kontrate.

### 10.3 Transferimet

As Pengdhenesit, as Shoqeria nuk mund te transferojne apo kalojne, teresisht apo pjeserisht asnje nga te drejtat e tyre sipas kesaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim te Kredidhenesit.

### 10.4 Rivendosja teresore e te drejtave

Te gjitha te drejtat, veprimet dhe perfitimet e Kredidhenesit sipas kesaj Kontrate jane shtese dhe nuk perjashtojne asnje te drejte, veprim apo shperblim tjeter mbi te cilin Kredidhenesia ka te drejta ne kuptimin kontraktual (pershire, pa kufizim, ato te Kontrates se Kredise) apo ne ligj.

### 10.5 Kontrate e Pengut dhe Titulli Ekzekutiv

Shoqeria dhe Pengdhenesit pranojne se (a) kjo Kontrate perben nje "Kontrate Pengu" ne kuptim te Kodit Civil, dhe (b) secila nga Kontratat e Kredise perbejne "titulli ekzekutiv"ne kuptim te te Nenit 510 te Kodit te Proçedures Civile.

### 10.6 Garantimi i interesave te posaçme

Te gjitha Palet ketu pranojne dhe konfirmojne shprehimisht se Pengu e krijuar sipas kesaj Kontrate perben nje garanci ne favor te Bankes, te ndare dhe pa lidhje me, çfaredolloj garancie tjeter qe i eshte dhene apo do t'i jepet nga Shoqeria ose ndonje nga aksionaret e Shoqerise per te siguruar permbushjen e Detyrimeve te Garantuara. Palet ketu bien dakort se Banka ka te drejte te ushtroje te drejtat e saj qe rrjedhin nga kjo Kontrate pavaresisht nga te drejtat e saj qe rrjedhin nga ndonje garanci tjeter per shlyerjen e Detyrimeve te Garantuara.

10.7 Ndashmeria

Dispozitat e secilit prej Neneve dhe paragrafeve te kesaj Kontrate jane te zbatueshme pavaresisht njera-tjetra dhe vlefshmeria e tyre nuk cenohet nese cilado nga te tjerat eshte e pavlefshme. Nese njera nga dispozitat eshte nul por do te ishte e vlefshme nese pjese e saj do te ishte fshire, dispozita ne fjale zbatohet me ata ndryshime qe mund te jene te nevojshme per ta bere ate te vlefshme.

10.8 Gjuha e Kontrates

Kjo Kontrate nenshkruhet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe ne prani te perkthyesit, nje per pengdhenesit, nje per noterin, nje do te depozitohet ne Qendren Kombelare te Regjistrimit dhe dy per banken.

10.9 Pranuesit e Kontrates

Pranuesit e Kontrates deklarojne se jane dakord me efektet juridike te krijuara nepermjet kesaj Kontrate Pengu mbi Aksionet/kuotat, dhe vendosjen e Pengut ne favor te Kredidhesit mbi Aksionet/Kuotat e zoteruara nga Pengdhenesit individe.

11. Verifikimi dhe raportimi i te dhenave

Pranuesit e Kontrates deklarojne se jane dakord me efektet juridike te krijuara nepermjet kesaj Kontrate Pengu mbi Aksionet/Kuotat, dhe vendosjen e Pengut ne favor te Kredidhesit mbi Aksionet/Kuotat e zoteruara nga Pengdhenesit .

Palet ne keke kontrate bien dakord dhe deklarojne si me poshte :Duke kuptuar se, te dhënat tona demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk do të transferohen në një shtet të tretë, si dhe për faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme:

Autorizoj Raiffeisen Bank që, për qëllimet që përfshijnë:

1. vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,

të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/afësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen , të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nenshkrues te kontrates , pra si per kredimarrësit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per pengdhenesit dhe pranuesit e kesaj kontrate.

12 LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURISDIKSIONI

12.1 Ligji i zbatueshem

Kjo Kontrate rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin e Republikës se Shqipërisë.

12.2 Juridiksioni

Çdo mosmarreveshje qe mund te ngrihet ne lidhje me keke Kontrate do te zgjidhet me mirekuptim; ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Une, Noteria pasi i lexova me ze te larte paleve keke Kontrate, konstatova se palet e gjejne Kontraten ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe une Noteria vertetoj se nenshkruajne Kontraten ne perputhje me ligjin.

P A L E T

KREDIDHENESI/BARREMARRES

Raiffeisen Bank Sha  
Perfaqesuar nga:  
Alketa EMINI



KREDIMARRRES

Shoqeria "HROMODHOMIA ALBANIA" shpk  
Perfaqesuar nga  
Aristotel Mindili

*Aristotel Mindili*  
Shoqeria "COLOR BODY" shpk  
Perfaqesuar nga:  
Aristotel Mindili

*Aristotel Mindili*

BARREDHENES

Aristotel Mindili

*Aristotel Mindili*

Polizoi Mindili

*Polizoi Mindili*

Savvas Chaliampalias

*Aristotel Mindili*

NOTER



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE KORÇE

NR. 1445 REP.

NR. 1030 KOL.

Taksa e pulles e paguar  
depozituar ne zyren e noterise

**PROKURE E POSACME**

Ne Korçe, sot me date 24.04.2013 (njezet e kater prill dymije e trembedhjete ) para meje Notere Flora Biba, anetar i Dhomes se Noterise Korçe, ne zyren time rruga 28 Nentori, perballe Deges se Tatimeve u paraqit personalisht:

**I PERFAQESUARI:** **Savvas Chaliampalias** datlindja 11.04.1963, shtetas Grek banues ne Greqi, madhor i afte per te kryer veprime juridike i identifikuar prej meje me ane te dokumentit nr AH3309735 i cili paraqitet me Perkthyesin e Greqishtes Andrea Çani si te besuarin e tij.

**BAZA LIGJORE:** Neni 64 e vijues te Kodit Civil te Shqiperise, Ligji Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", legjislacioni i fushes ne fuqi.

*I perfaqesuari kerkoi nga une redaktimin e kesaj prokure te posacme si me poshte vijon:*

Une i perfaqesuari, jam aksioner ne shoqerine Hromodhomia Albania shpk ku zoteroj 50 % te kapitalit te shoqerise.

Shoqeria ka aplikuar prane Raiffeisen Bank Dega Korce per nje kredi.

Duke qene se nuk do te jem vete personalisht emerorj perfaqesues te posacem z. Aristotel Mindili me nr personal H10328051Q te cilit I jap te drejte dhe porosi qe:

Ne emer tim dhe per llogarine time te neneshkruaje Marreveshjen Siguruese dhe Pengu Mbi Kuotat e Pjesmarjes ne Shoqeri qe une zoteroj duke rene dakort me kushtet e kontrates per vendosjen e 50 % te pjeseve te kapitalit qe une zoteroj ne kete shoqeri si garanci per sigurimin e kredise.

Me kete rast i porosituri prej meje ka te drejte te neneshkruaje kontraten e siperpermendur si dhe cdo dokument tjeter te nevojshem plotesues.

Te gjitha veprimet e kryera nga Perfaqesuesi Brenda tagrave te kesaj prokure ne funksion te mandatit te sipercituar shprehimisht I konsideroj te mireqena njelloj sikur te ndodhesha vete une personalisht.

Sa me siper, Prokura e Posacme e cila u perpilua e redaktua, konform vullnetit te te Perfaqesuarit, ne tre kopje me vlere te njejte ligjore, nga une Notere Flora Biba, i cili, pasi ja lexova me ze te larte dhe te qarte, ishin plotesi Sht dakort me permbajtjen e prokures dhe e nenshkruan ate para meje.

Une Noteri, vertetoj teresisht aktin dhe nenshkruaj ne baze te ligjit.

**I PERFAQESUARI**  
**Savvas Chaliampalias**

**PERKTHYES**  
**Andrea Çani**

**NOTER**  
**FLORA BIBA**

ΣΑΒΒΑΣ ΧΑΛΙΑΜΠΑΛΙΑΣ

Endri Ull. Çani

ENDRI ULL. ÇANI  
T: K44023003A  
CEL: 0684048797  
KORÇE - ALBANIA

Angjela Gjermano